

VENDIM
Nr. 178, datë 13.7.2022

**MBI ZGJIDHJEN E ANKESËS SË SHOQËRISË “ANIO OIL & GAS” SHA, PËR TË
LICENCUARIN, SHOQËRINË “ALBPETROL” SHA**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, nenit 16, pika 3, nenit 20, germa “a” dhe nenit 27, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 19 dhe 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 935 prot., datë 15.6.2022, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi shqyrtimi e ankesës së shoqërisë ‘ANIO OIL & GAS’ sh.a. mbi zgjidhjen e ankesës së shoqërisë ‘Anio Oil & Gas’ sh.a., me të licencuarin ‘Albpetrol’ sh.a., lidhur me detyrimin e instalimit të sistemit të matjes së energjisë elektrike, si dhe përcaktimin e sasisë së energjisë elektrike të konsumuar, çmimit të energjisë dhe detyrimin total që shoqëria ‘Anio Oil & Gas’ sh.a., ka ndaj shoqërisë ‘Albpetrol’ sh.a.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Anio Oil & Gas” sh.a., me shkresën nr. 20 prot., datë 22.2.2022, ka paraqitur pranë ERE-s, ankesën me nr. 295 prot., datë 23.2.2022, ndaj shoqërisë “Albpetrol” sh.a.

- Me shkresën me nr. 295/2 prot., datë 2.3.2022, shoqëria “Anio Oil & Gas” sh.a. dhe shoqëria “Albpetrol” sh.a. u njoftuan për zhvillimin e një seance dëgjimore. Kjo seancë u zhvillua më datë 7.3.2022, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërisë “Anio Oil & Gas” sh.a., shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe përfaqësuesve të ERE-s.

- Në vijim të kësaj seance si dhe pas diskutimeve e pretendimeve të palëve në këtë mosmarrëveshje, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre si palë, në kontratën e lidhur për qëllim sigurimin e furnizimit me energji elektrike të shoqërisë “Anio Oil & Gas” sh.a., ERE me shkresën 295/3 prot., datë 11.3.2022, kërkoi që shoqëritë “Anio Oil & Gas” sh.a. dhe shoqëria “Albpetrol” sh.a. të përcjellin *jo më vonë se data 18.3.2022* në ERE çdo dokumentacion që shërben për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje e mbi të cilat mbështesin qëndrimin e tyre.

- Nëpërmjet shkresës me nr. 43 prot., datë 18.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 295/4 prot., datë 18.3.2022, shoqëria “Anio Oil & Gas” sh.a. ka përcjellë shpjegimet e saj.

- Me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të palëve, ERE me shkresën nr. 427 prot., datë 30.3.2022 i është drejtuar Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., me kërkesë për informacion në lidhje me kushtet e garantimit të shërbimit të furnizimit si dhe çmimit të faturuar për klientin e energjisë elektrike, shoqërinë “Albpetrol” sh.a., me anë të cilës ka kërkuar nga ana e FSHU sh.a., informacion në lidhje me numrin e kontratave për të cilat FSHU sh.a., garanton shërbimin e furnizimit për shoqërinë “Albpetrol” sh.a., nivelin e tensionit në të cilin janë lidhur klientët e tij si dhe tarifën/tarifat e aplikuara nga ana e FSHU sh.a., për këtë shoqëri.

- Në nenin 8, pika 8.1 e rregullores “Për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror” parashikohet se: çdo klient ka të drejtë të drejtohet me ankesë pranë ERE-s në këto raste: pika 8.1.1: në rast se i licencuari, me anë të veprimeve ose mosveprimeve të ndërmarra nga ana e tij, ka shkelur dhe cenuar kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike dhe furnizimit të shërbimit universal, si dhe akteve të tjera që lidhen me furnizimin me energji elektrike dhe gaz natyror, të miratuara nga ERE.

- Në kuptim të sa më sipër, shoqëria “Anio Oil & Gas” sh.a., legjitimohet për të paraqitur një ankesë në ERE. Në nenin 12, pika 12.2.3 e rregullores së sipërcituar, parashikohet se: në përfundim

të seancës dëgjimore, ERE do të shprehë qëndrimin e saj, lidhur me ankesën, dhe nëse është e nevojshme, nëpërmjet vendimit të Bordit.

- Nëpërmjet shkresës së saj nr. 22 prot., datë 30.1.2020, regjistruar në ERE me nr. 386 prot., datë 3.2.2020, shoqëria “Anio Oil & Gas” sh.a. ka kërkuar adresimin e së njëjtës problematikë dhe ERE, më shkresën nr. 386/1 prot., datë 13.2.2020, pasi ka shqyrtuar rrethanat e ankesës, ka adresuar zgjidhjen e saj nëpërmjet rekomandimit të përcjellë në të dyja palët, duke adresuar si më poshtë:

- Nëpërmjet shkresës nr. 386/1 prot., datë 13.2.2020, ERE ka kërkuar: 1. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. të zbatojë me përpikëri vendimarrjen e ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018, “Mbi tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2019”, ku ndër të tjera rezultojnë që çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV është 14 lekë/kWh. Ky çmim është përlogaritur mbështetur në përcaktimet e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin nr. 189, datë 23.11.2017 të bordit të ERE-s. Në këtë çmim është llogaritur edhe tarifa e mirëmbajtjes së rrjetit, shërbim i cili ofrohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. 2. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. të korrigjojë çdo faturë të lëshuar në kundërshtim me sa më sipër dhe të kryej kompensimin e shoqërisë “Anio Oil & Gas” sh.a., për mbifaturimin e kryer gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies mes palëve.

- Nëpërmjet shkresës nr. 804/1 prot., datë 17.7.2021, ERE ka vijuar korrespondencën drejtuar shoqërisë “Albpetrol” sh.a., dhe për dijeni Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), mbi problematikën e krijuar midis shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Anio Oil & Gas” sh.a., me anë të së cilës ka bërë me dije se ERE i qëndron konstatimeve të përshkruara edhe me herët.

- Konstatojmë se më datë 16.7.2018 shoqëria “Anio Oil & Gas” sh.a. ka lidhur një kontratë furnizimi me energji elektrike me shoqërinë “Albpetrol” sh.a. (nr. 5208/2 prot. i shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe nr. 9/1 prot., i shoqërisë “Anio Oil&Gas” sh.a.). Në këtë kontratë, shoqëria “Anio Oil & Gas” sh.a. është në cilësinë e klientit dhe shoqëria “Albpetrol” sh.a. në cilësinë e furnizuesit me energji elektrike. Kjo kontratë është lidhur për furnizimin me energji elektrike të shoqërisë “Anio Oil & Gas” sh.a. në vendburimin Ballsh-Hekal. Shoqëria “Anio Oil & Gas” sh.a. furnizohet me energji elektrike në linjat e tensionit të ulët, pra është klient i lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV.

- Në nenin 6 të kontratës parashikohet se: në bazë të legjislacionit në fuqi, që rregullon sektorin e energjisë elektrike çmimi i energjisë elektrike sipas Entit Rregullator të Energjisë (ERE) do të jetë 17.4 leke/KWh për orë, pa TVSH. Çmimi, përbërësit e tij, struktura tarifore orare apo sipas nivelit të tensionit i bëhen të ditura klientit në faturën e konsumit të energjisë elektrike.

- ERE, me vendimin nr. 190, datë 30.8.2018, ka vendosur lënien në fuqi për vitin 2018, të pikave 3, 4 dhe 5, të vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 211, datë 28.12.2017, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a., për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënies në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018”.

- Rezultojnë se çmimi i shitjes së energjisë për klientët fundorë për nivelin e tensionit 0.4 kV, ka qenë 14 lekë/kWh. Shoqëria “Albpetrol” sh.a., fillimisht për muajin korrik 2018 (muaji i parë i kontratës) ka faturuar me çmimin prej 17.4 lekë/kWh dhe në faturën pasardhëse ka bërë aplikimin e çmimit sipas ERE-s dhe e ka vendosur atë në vlerën prej 14 lekë/kWh, por, nga ky muaj shoqëria “Albpetrol” sh.a., ka shtuar në faturë edhe një zë tjetër, i cili i referohet një tarife shërbimi në vlerën prej 3.4 lekë/kWh.

- Në kontratën e dakordësuar mes palëve nuk është parashikuar reflektimi i një vlere shtesë mbi çmimin e aplikuar të kontratës për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. rezulton se aktualisht nuk ka licencë operimi sistem i mbyllur i shpërndarjes.

- Shoqëria “Albpetrol” sh.a., energjinë me të cilën furnizon klientët e lidhur në rrjetin e saj, e blen të treg të rregulluar nga FSHU sh.a., si pjesë e detyrimit të shërbimit publik me vlerën 11 lekë/kWh dhe duhet ta shesë me të njëjtën çmim që FSHU sh.a. e shet për klientët e lidhur në tensionin 0.4 kV (14 lekë/kWh).

- Çmimi i përlogaritur dhe i miratuar nga ERE sipas vendimmarrjeve respektive për garantimin e shërbimit të furnizimit nga ana e FSHU sh.a., miratuar me vendimin nr. 189, datë 23.11.2017, të Bordit të ERE-s parashikon që këta klientë të faturohen në nivelin 0.4 kV me çmimin prej 14 lekë/kWh i cili përfshin në të dhe tarifën e shërbimit për shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike nga pika e hyrjes së energjisë elektrike (TM) të rrjetit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. deri në pikën e furnizimit të klientit shoqërisë “Anio Oil & Gas” sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. të bëjë korrigjimin e faturave të aplikuara nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. ndaj shoqërisë “Anio Oil & Gas” sh.a., për periudhën korrik 2018–dhjetor 2021, sipas çmimeve të përcaktuara nga ERE, miratuar me vendimin nr. 189, datë 23.11.2017, të Bordit të ERE-s, prej 14 lekë/kWh, brenda datës 31.7.2022.

2. Shoqëria “Anio Oil & Gas” sh.a. të shlyejë detyrimet e prapambetura sipas kontratës ndaj shoqërisë “Albpetrol” sh.a., të llogaritura sipas çmimeve të miratuara nga ERE deri në dhjetor të vitit 2021.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti